



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT



Nr. protokolli: 534/23

Data: 19.06.2023

Bazuar në Rregulloren (KKV) Nr.01/2023 - Për ndarjen e bursave për nxënës, studentë dhe shpërblimeve për nxënës, studentë të Komunës së Vushtrrisë me Nr.47/2023, të datës: 23.02.2023, Neni 5, si dhe në Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.729/2023 të datës: 09.06.2023. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Vushtrrisë për vitin akademik 2022/23.

- **Numri i bursave brenda vendit – 65 (gjashtëdhjetë e pesë);**
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- **Numri i bursave jashtë vendit – 15 (pesëmbëdhjetë);**
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;

Numri i bursave për fushat e studimit:

Drejtimit deficitare	Numri i bursave Baçelor	Numri i bursave Master
Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Matematikë	2	1
Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Kimi	1	1
Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Fizikë	1	1
Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Biologji	1	1
Fakulteti i Filologjisë: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	1	1
Fakulteti i Shkencave Matematikë - Natyrore: Shkence-Kompjuterike	10	2
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtëritshme	2	1
Fakulteti i Ndërtimtarisë: Gjeodezi	2	2
Fakulteti i Mjekësisë – Mjekësi e përgjithshme	15	/
Fakulteti i Mjekësisë – Infermieri	3	/
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë: Ekonomia e Bujqësisë	2	2
Fakulteti i Arkitekturës: Arkitekturë	5	2
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Automatikë e Kompjuterizuar dhe Robotikë	2	1
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike: Elektronikë	2	1

Bursa për studentë jashtë vendit		
Mjekësi	5	0
Arkitekturë	3	2
Shkenca kompjuterike	3	2

I. Kriteret vlerësuese

II.1. Kriter për vlerësim të ndarjes së bursave merret nota mesatare, më përparësi nota më e lartë;

II.2. Në kushtet të njëjta të notës mesatare, përparësi u jepet nxënësve dhe studentëve me gjendje të rëndë sociale, të cilat janë:

- II.2.1 Fëmijë të dëshmorëve
- II.2.2 Fëmijë të martirëve
- II.2.3. Fëmijë të invalidëve
- II.2.4. Fëmijë të veteranëve
- II.2.5. Fëmijë të ish burgosurve politikë
- II.2.6. Fëmijë të familjeve me asistencë sociale
- II.2.7. Fëmijë pa njërin, apo të dy prindërit

II. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

- III.1. Dëshmia e regjistrimit të vitit të studimeve me certifikatën e provimeve;
- III.2. Dëshmia se është banor i Komunës së Vushtrrisë (Ekstraktin e lindjes);
- III.3. Dëshmia se nuk merr bursë apo pagë nga buxheti i Kosovës;
- III.4. Dëshmia se është fëmijë i dëshmorit , martirit, invalidit të Luftës të UÇK-së, veteranit të Luftës së UÇK-së, ish të burgosurit politik, dhe se është nga familja me gjendje të rëndë ekonomike- sociale;

Vëmendje:

- Dokumentet e pakompletuara sipas kriterëve të lartcekura dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen;
- Nëse nuk ka kandidatë student/e të mjaftueshëm në një fushë, atëherë bursa e mbetur kalon te fushat tjera, brenda konkursit bazuar në notën mesatare;
- Studentët jashtë vendit mund të aplikojnë vetëm në kategorinë: Bursa për studentë jashtë vendit;

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data:20.06.2023 -10.07.2023.

Aplikacioni merret dhe i plotësuar dorëzohet në sportelet e katit të parë në Komunën e Vushtrrisë (çdo ditë prej orës: 8:00- 16:00)

Afati i ankesave:

Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës komunale, kanë të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, nga dita e publikimi të listës jo përfundimtare.

Publikimi i vendimit:

Njoftimi do të bëhet në webfaqe të komunës dhe në tabelën e shpalljes në komunë.



Drejtori i DKA-së

Dardan Abazi